

VENDIM
Nr. 629, datë 7.9.2016

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“NDËRTIMI I GALERISË PËR KABLOT E RRJETIT SHPËRNDARËS TË
NËNSTACIONIT QENDËR 110/20 kv”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i galerisë për kablot e rrjetit shpërndarës të nënstacionit qendër 110/20 kv”, Tiranë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe “tokë truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme të shpronësimit 98 355 494 (nëntë-dhjetë e tetë milionë e treqind e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 98 355 494 (nëntëdhjetë e tetë milionë e treqind e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë në datën e botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Tiranë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA PËR SHPRONËSIMIN E PASURIVE QË PREKEN NGA PROJEKTI ‘NDËRTIMI I GALERISË PËR KABLOTT E RRJETIT SHPËRNDARËS TË NËNSTACIONIT QENDËR 110/20 kv’

Nr.	Emër, mbiemër	Zona kadastr.	Nr. i pasurisë	Sipërfaq. e përgj. tr./ m²	Sip. Tr. të prekur/ m²	Çmimi për tr. m²	Vlefëta në lekë tr.	Sip. Obj. të prekur / m²	Çmimi për obj. m²	Vlefëta në lekë obj.	Vlefëta e përgjithshme	Konfirmimi i ZVRPP-së Tiranë
1	Bashkëpr. Karaj, Malja, Çeliku	8360	6/194	355.92	202.00	66,969	13,527,738	0	0	0	13,527,738	Plotësim dokumentacioni
2	Bashkëpr. Kore, Gjerazi	8360	6/222	85.20	85.20	66,969	5,705,759	0	0	0	5,705,759	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Sabire Jaup Kore	8360	6/158	84.4	84.40	66,969	5,652,184	0	0	0	5,652,184	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Bashkëpr. Buli, Trebecka	8360	6/192	338.5	338.50	66,969	22,669,007	96.5	40,019	3,861,834	26,530,840	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Bashkëpr. Axha, Gëdeshi, Samarxhia (Çepunja)	8360	6/191	292.1	268.10	66,969	17,954,389	80	40,019	3,201,520	21,155,909	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	Bashkëpr. Axha, Gëdeshi, Samarxhia (Çepunja)	8360	6/244	40.00	40.00	66,969	2,678,760	0	0	0	2,678,760	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	GECI sh.p.k.	8360	6/300	5800	70.00	66,969	4,687,830	0	0	0	4,687,830	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	Bashkëpr. Buneci	8360	6/193	472	37.00	66,969	2,477,853	0	0	0	2,477,853	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	Bashkëpr. Dashi, Pulaj, Hallulli, Skënderi, Pilinçi, Daka, Fortuzi, Durda dhe Vathi.	8360	6/216	179	98.00	66,969	6,562,962	0	0	0	6,562,962	Plotësim dokumentacioni
10	Iljaz Këllezi	8360	6/188	379	140.00	66,969	9,375,660	0	0	0	9,375,660	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
SHUMA TOTALE											98,355,494	Lekë